UDHËZIM
Nr. 16, datë 12.8.2016

PËR PROCEDURAT PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT TË RISKUT PËR ÇDO VEND PUNE NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 10237, DATË 18.2.2010, "PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Punëdhënësi kryen vlerësimin e riskut për çdo vend pune nëpërmjet hartimit të dokumentit të vlerësimit të riskut , përfshirë dhe grupet e punëmarrësve të ekspozuar ndaj risqeve të veçanta.

2 Në hartimin e dokumentit të vlerësimit të riskut si dhe në planifikimin e masave parandaluese marrin pjesë përfaqësuesit e punëmarrësve për sigurinë dhe shëndetin në punë.

3. Punëdhënësi në hartimin e dokumentit të vlerësimit të riskut respekton parimet e mëposhtme të parandalimit të riskut:

a) shmangia e risqeve;

b) vlerësimi i risqeve që nuk mund të shmangen;

c) luftimi i risqeve në burim;

dh) zëvendësimi i të rrezikshmes me të parrezikshmen ose më pak të rrezikshmen;

ë) dhënia prioritet masave mbrojtëse kolektive në raport me masat mbrojtëse individuale;

f) dhënia e udhëzimeve të përshtatshme për punonjësit

4. Punëdhënësi, pas kryerjes së vlerësimit të riskut, sipas pikës 1 të këtij udhëzimi, harton planin e masave parandaluese dhe mbrojtëse, si masat teknike, mjekësore, organizative dhe higjieno-sanitare, në bazë të kushteve të punës që janë specifike në ndërmarrje.

5. Punëdhënësi informon punëmarrësit dhe përfaqësuesit e tyre mbi rezultatet e vlerësimit të riskut në çdo vend pune dhe masat e propozuar për eliminimin e tij.

6. Punëdhënësi konsulton në Këshillin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë dokumentin e vlerësimit të riskut si dhe planin e masave parandaluese dhe mbrojtëse.

Punëdhënësi është i detyruar të zbatojë propozimet e bëra nga këshilli i sigurisë dhe shëndetit në punë, duke bashkëpunuar me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Inspektoratin Sanitar Shtetëror.

7. Inspektorati Shtetëror i Punës harton Manualin e vlerësimit të riskut, jo ligjërisht të detyrueshëm, në ndihmë:

- të inspektorëve të punës për të siguruar zbatueshmërinë e procedurave të vlerësimit të riskut, zbatimin dhe menaxhimin e tij
- të punëdhënësit për përmbushjen e detyrimeve të tyre
- të specialistëve të sigurisë dhe shëndetit në punë në kryerjen e vlerësimit të riskut.

8. Manuali publikohet në faqen zyrtare të inspektoratit të punës: http://www.sli.gov.al/.

9. Ngarkohet Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Inspektoratin Sanitar Shtetëror për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË
Blendi Klosi